



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarsvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Kancelarija Ministra Pravde - Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 265 / 2025

Datë: 21 / 05 / 2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në përputhje me nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1 dhe 3) të Ligjit Nr. 06/L-010 për Noterinë, si dhe në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores (QRK) - nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Zëvendësministri në detyrë i Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shfuqizohet Vendimi Nr. 204/2025, i datës 14.04.2025 për emërimin e znj. Floriana (Selman) Rugova në detyrën e noterit, në juridiksionin territorial të Komunës së Parteshit.
2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj. Floriana (Selman) Rugova pas propozimit të Komisionit për Zgjedhjen e Noterëve për kandidatët që i plotësojnë kushtet për të ushtruar funksionin dhe shërbimin noterial në Republikën e Kosovës, me Vendimin Nr.204/2025, të datës 14.04.2025 është emëruar në detyrën e noterit në juridiksionin territorial të Komunës së Parteshit.

Me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L- 010 për Noterinë (neni 11, paragrafi 1) përcaktohet se pas emërimit, noteri është i detyruar që të jap betimin. Në këtë rast, noteri i emëruar znj. Rugova nuk i është përgjigjur ftesës për dhënien e betimit.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat dhe legjislacionin përkatës në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Blerim SALLAHU

Zëvendësministër në detyrë i Drejtësisë

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

Vendimi i'u dërgohet:

- *Znj. Floriana Rugova;*
- *Sekretares së Përgjithshme;*
- *Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika;*
- *Odës së Noterëve të Kosovës;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*